



Arsimi ndërkulturor

mënyra bashkëpunimi të prindërve me shkollën

Keni dëgjuar për arsimin ndërkulturor; është një përfaqje pedagogjike që synon pranimin e nxënësve me kultura të ndryshme dhe përdorimin e këtyre kulturave në shkollë dhe në shoqëri. Arsimtarët që zbatojnë këtë parim u japin rëndësi kulturave dhe gjuhëve të ndryshme dhe kërkojnë të përforcojnë tek fëmijët (vendat dhe të ardhur) zhvillimin e aftësive të përshtatshme, me qëllim përmbushjen e kërkesave shumëkulturore të një shoqërie.

Ju, prindërit, luani një rol veçanërisht të rëndësishëm në një edukim të tillë. Ju jeni shprehës të identitetit kulturor të komunitetit tuaj. Që të arrihen synimet e arsimit ndërkulturor, është e nevojshme të tregoni në shkollë kulturën tuaj, e cila shpesh nuk njihet. Nuk njihet, ndoshta, për arsye të mungesës së bashkëpunimit midis familjes dhe shkollës, ose për arsye të mungesës së formimit të posaçëm të arsimtarëve.

Informohem
rreth arsimit

Sa e rëndësishme është të njihet identiteti juaj kulturor në klasë?

Kur ka të bëjë me fëmijën tuaj, kontribuon në:

- të ndihet pjesë e së tërës dhe jo si «i huaj» në klasë.
- të vlerësojë origjinën e tij, si element i identitetit të tij.
- të mos ketë «turp» për prindërit e tij që, ndoshta, flasin një gjuhë tjetër, kanë fe tjetër, kanë zakone të tjera kulturore nga prindërit e nxënësve të klasës së tij, etj. Në disa raste «turpi» është shkak i tensioneve me prindërit, përderisa fëmija përpiqet të integrohet në ambientin e gjerë.
- të ketë më shumë vetëbesim dhe vetëvlerësim.
- të lidhë arsimin e tij me eksperiencat e tij nga shtëpia. Kështu ndihet se i përket shkollës dhe është i pranueshëm prej saj.
- të arrijë rezultate më të larta në mësim duke përdorur dygjuhësinë e tij në klasë, meqë dygjuhësia ka shumë avantazhe (shih «Dygjuhësia dhe Arsimi»).

Përsa i përket avantazheve që ka prezenca e kulturës dhe e gjuhës suaj në klasë, për të gjithë fëmijët, pamvarësisht nga origjina e tyre, lexoni si më poshtë:

- Mirëkuptohet e «ndryshmja» si pjesë e pandarë e jetës së tyre.
- Me vlerësimin e drejtë të kulturës «së ndryshme» nga mësuesi/ja, parandalohen dhe shpërbëhen stereotipat përgjithësues, paragjykimet dhe sjelljet raciste.
- Zgjerohen njohuritë kulturore.
- Zhvillohet mendimi dhe perceptimi kritik.
- Përgatiten për t'u bërë «qytetarë të botës».

Gjithashtu përfitojnë edhe vetë mësuesit/et përderisa:

- marrin “ngacmime” kulturore në mënyrë që ta bëjnë më interesante dhe krijuese mësimdhënien e tyre.
- kanë rastin të vijnë përballë me paragjykimet e tyre dhe të ndeshen me to.
- mësojnë të dhëna që nuk i njohin për jetën e nxënësve dhe të nxënësve të tyre, të familjeve dhe të komuniteteve të tyre, duke ardhur më pranë kështu me ta dhe me ju.

Ndoshta kontakti juaj i parë me mësuesit nuk është i lehtë dhe ju mbush me ankth mendimi se si do t'ju presin në shkollë. Por, të gjitha sa thamë më lart, argumentojnë më së miri faktin se ju dhe ata duhet të merrni kurajo dhe të guxoni. Më e mundshme është të shkaktoni një surprizë të këndshme në shkollë dhe ta vlerësojnë përpjekjen tuaj. Gjithashtu, duhet të keni parasysh se shkolla ka për detyrë të ofrojë për të gjithë fëmijët shkollim të përshtatshëm, pamvarësisht nga origjina, feja dhe kombësia e tyre. Që të kapërceni hezitimin fillestar, përqëndrohuni se si mund të bëni më të mirë arsimin e fëmijës suaj në bashkëpunim me shkollën.

Disa ide për materialet që sjellin kulturën tuaj në klasë.

Përralla dhe libra

Sillni në klasë përralla të ilustruara me figura dhe libra në gjuhën tuaj. Do të ngjallin shumë interes tek fëmijët ndryshimet në mënyrën e të shkruarit dhe të ilustrimit figurativ të përrallave klasike, të historive dhe të përrallave që janë të famshme në vendin e origjinës suaj. Gjithashtu interes do të kenë edhe librat që përshkruajnë histori jo të njohura për të gjithë. Zgjidhni tregime të shkurtra me fjalë të thjeshta, me qëllim që të mundet mësuesi/ja t'i mësojë dhe t'ua rrëfejë fëmijëve. Gjithashtu, në bashkëpunim me mësuesin/en, mund t'i rrëfeni ju para fëmijëve; vetëm ose dhe me fëmijën tuaj. Nëse nuk ndiheni rehat me greqishten, kërkoni ndihmën e një shoku apo shoqeje (akoma më mirë nëse dhe ai/ajo ka fëmijë në të njëjtën klasë!).



Kartona me fjalë, numra dhe festa

Vizatoni në karton fjalë të thjeshta të së përditshmes (p.sh. «mirëdita», «drekën e mirë» e.t.j.), me përkthimin dhe shqiptimin e tyre në greqisht (kërkoni ndihmën e mësuesit/es). Përdoreni si shans për të luajtur me fëmijën tuaj, duke e bërë atë në shtëpi sëbashku. Kërkojini t'ju japë ide për fjalë të ndryshme të gjuhës së tij amtare të cilat ka dëshirë t'i ndajë me shokët e shoqet e tij të klasës. Të njëjtën gjë mund të bëni edhe me numrat, (nëse shënohen ndryshe në gjuhën tuaj), festat ose ritet e zakonet që janë karakteristike të jetës suaj në shtëpi. Jepeni kartonin në klasë, që të varet në mur; do të funksionojë si nxitje të bëjnë edhe prindërit e tjerë të njëjtën gjë!

Fotografi familjare

Ngjitni në një fletore fotografi nga çaste të përditshme apo të veçanta të familjes suaj, duke shkruar një përshkrim të shkurtër të fotografisë dhe emrat e personave.

Kukulla, lodra dhe këngë fëminore

Sillni në shkollë ndonjë kukull me karakteristika të ndryshme nga ato të tregut grek dhe i vini një emër të zakonshëm që përdoret në vendin e prejardhjes suaj. Bëni të njëjtën gjë me lodra tavoline ose me CD me këngë për fëmijë, të cilat janë të thjeshta për t'i mësuar fëmijë që nuk e njohin gjuhën tuaj. Mund t'i sillni në shkollë, t'u tregoni si luhen ose si këndohen dhe, pse jo, jepini idenë mësuesit/es t'i përdorë si pjesë të programit arsimor.



Kultura që përplasit me kulturën e shkollës. Çfarë mund të bëj?

Kjo çështje është shumë e rëndësishme, por dhe delikate, prandaj dhe nevojitet kujdes i veçantë. Sigurisht, mënyra e zgjidhjes së saj, bazohet në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin reciprok me shkollën. Më poshtë do të gjeni disa nga hapat që mund të parandalojnë ose të zgjidhin këto lloj përplasjesh.

- Në fillim të vitit, njoftoni mësuesin/en dhe bisedoni për çështjet që mendoni se janë të ndjeshme për ju dhe fëmijën tuaj (gjendja familjare dhe ekonomike, lutja e mëngjesit dhe lënda e fesë, shamia në kokë dhe veshja me pantallona, uniforma e fiskulturës për vajzat, vaksinimi, e.t.j.).
- Kërkoni të informoheni për festat, përvjetorët dhe traditat ceremoniale të shkollës (p.sh. «tradita» e ngritjes së flamurit nga nxënësi/ja e dalluar, parakalimet, e.t.j.), si dhe për të drejtën e pjesëmarrjes ose jo në to.
- Gjithashtu, njoftoni në kohë shkollën për festat ose ngjarjet e veçanta, për të cilat, ndoshta, fëmija juaj duhet të mungojë nga shkolla.
- Informohuni për të drejtat e fëmijës suaj. Për shembull, ligji parashikon krijimin e klasave përforcuese për mësimin e greqishtes, (klasat pritëse dhe grupet suplementare), si dhe mundësinë e krijimit, sipas kushteve, të klasave të gjuhës amtare në shkollë (www.ipode.gr).
- Në çdo rast vështirësie në përdorimin e gjuhës greke, mund të kërkoni nga shkolla, në bashkëpunim me ndonjë prind ose organizatë që punon për emigracionin dhe arsimin, t'ju përkthejë këto informacione.
-



Nëse për një arsye serioze, ndiheni se ka përplasje të papajtueshme midis jush dhe shkollës, por dhe për çdo çështje ligjore që ka të bëjë me shkollimin e fëmijës suaj, mund t'i drejtoheni Avokatit të Fëmijës në faqen elektronike www.0-18.gr dhe Avokatit të Popullit në faqen www.sinigoros.gr. Së fundmi, rikujtojmë se, sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit (73025/Γ2/23-6-2010), të gjithë të miturit që banojnë në Greqi, **kanë të drejtë të ndjekin arsimin fillor dhe të mesëm, pamvarësisht statusit të qëndrimit të tyre.**



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Evi Marku, Institute of Education, University of London

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit

dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr

tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes

Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin

Evi Marku

Me mbështetjen e

